

VENDIM
Nr.316, datë 18.4.2020

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR LOTIN 2, ME OBJEKT “BLERJE KITE
DHE MATERIALE KONSUMI PËR BIOLOGJINË MOLEKULARE PËR ISHP”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e kontratës për lotin 2, me objekt “Blerje kite dhe materiale konsumi për biologjinë molekulare për ISHP”, të procedurës “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për diagnozën serologjike, të përshtatshme për pajisjen MAGLUM 800 të Snibe Co.Ltd ose ekuivalent në QSUT dhe blerje e materialeve të emergjencës për kryerjen e analizave diagnostikuese për COVID-19 në ISHP”, ndarë në lote, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik “Biometric Albania”, sh.p.k., që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama